

AKT THEMELIMI
DHE
STATUT
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“EMI & AMA HOLDING COMPANY” SH.P.K

Sot më datë **08/05/2023**, ortaku i vetëm i shoqërisë “**EMI & AMA HOLDING COMPANY**” **SH.P.K**, duke u bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, në ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 për “Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar; ligjin nr.131/2015, datë 26.11.2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, në ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, harton statutin e kësaj shoqërie.

KREU I
THEMELIMI, EMRI, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1
Emri dhe themeluesi

- 1.1 Shoqëria “**EMI & AMA HOLDING COMPANY**” **sh.p.k.** është person juridik i së drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).
- 1.2 Themelues i Shoqërisë është:
 - **Z.Gentian Lari**, i biri i Ramazan dhe Virgjinushe, i datëlindjes 13/07/1974, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, dhe me dokument identifikimi nr.: 037070563;

Neni 2
Objekti

Objekti i shoqërisë do të jetë blerja, shitja e aksioneve dhe kuotave në pjesëmarrje si dhe menaxhimi i letrave me vlerë ose të drejtave në kompani të ndryshme, pjesëmarrje në kuota në fonde investimi dhe instrumenta financiar, ofrimi i shërbimeve të konsulencave, blerjen, menaxhimin dhe zhvillimin e markave tregtare dhe patentave, blerjen, zhvillimin dhe administrimin e pasurive të luajtshme dhe paluajtshme, zotërim pronash.

Objekti gjithashtu përfshin pjesëmarrjen e shoqërisë, në çdo mënyrë, të drejtpërdrejt ose tërthorazi, në çdo transaksion që mund të lidhet me qëllimin e tij duke krijuar kompani të reja, blerje të titujve ose të drejtave sociale, shfrytëzimin ose transferimin e të gjitha proceseve dhe patentave në lidhje me këto aktivitete, të gjitha transaksionet industriale, komerciale, financiare, pasurive të luajtshme ose të paluajtshme që mund të lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë me qëllimin e shoqërisë. Tregti import export, bar-restorant etj, zhvillues dhe sipërmarrës i zonave të banimit dhe industriale. Shoqëria mund të kryej çdo lloj aktiviteti tjetër të lejuar me ligj.



Neni 3 Selia

- 3.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. "Myslym Shyri", Njësia Administrative Nr. 7; Njësia bashkiake nr. 7; 1023; Tiranë.
- 3.2 Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: lavinamael@web.de

Neni 4 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të përcaktuar.

KREU II KAPITALI I SHOQËRISË (ZMADHIMI, ZVOGËLIMI, TRANSFERIMI)

Neni 5 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është **100.000 Lekë**. Kapitali i shoqërisë zotërohet nga ortakut i vetëm themelues me 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 100.000 lekë, që përbëjnë 100% të kuotave të zotërimit të kapitalit të shoqërisë. Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortakut i vetëm themelues i shoqërisë.

Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet pa kufizim, në çdo moment, një apo disa herë dhe vetëm me Vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm, mbi bazën e raportit të hartuar nga Eksperti Kontabël, nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit të shoqërisë për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të ekspertit të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.
- 6.2 Zvogëlimi i kapitalit realizohet me Vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm, në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Ortakut të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.
- 6.3 Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar nga ligji i shoqërive tregtare, për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën nominale.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

- 7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:




- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi vendimmarrës

- 8.1 Asambleja e ortakut të vetëm është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.2 Duke qënë se shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.
- 8.3 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një person i tretë. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i



ortakut në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Thirrja e asamblesë së përgjithshme

- 9.1 Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, nga ligje të tjera ose sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
- 9.2 Asambleja e përgjithshme mund të thirret nga administratori ose nga ortaku i vetëm i saj.

Neni 10

Ndryshimet në statut

- 10.1 Ndryshimet në statut vendosen nga ortaku i vetëm.
- 10.2 Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet në QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë në regjistrin tregtar, duke aplikuar brenda 30 ditëve nga data e vendimit të ortakut të vetëm për ndryshimin e statudit.

Neni 11

Administrimi

- 11.1 Ortaku i vetëm themelues është njëkohësisht edhe administrator i shoqërisë:
 - Z. Gentian Lari, i datëlindjes 13/07/1974, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, dhe me dokument identifikimi nr 037070563 dhe nr personal H40713051C me specimentin e nënshkrimit bashkëlidhur.
- 11.2 Administratori do të ushtrojë kompetencat e tij për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rrimërimi. Administratori i shoqërisë do të emërohet dhe shkarkohet vetëm me vendim të ortakut të vetëm.
- 11.3 Asambleja e Ortakut të Vetëm, nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, mund të lejojë ortakët dhe administratorët e shoqërisë të mbajnë një pozicion drejtues, apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë e parë. Gjithashtu këta persona me këtë autorizim të posaçëm, mund të mbajnë statusin e tregtrait për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.

Neni 12

Kompetencat e Administratorit

- 12.1 Shoqria administrohet nga një ortak i vetëm. Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm.
- 12.2 Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjithë personave fizik dhe juridik, publik dhe/ose privat, vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshirë këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve.




- 12.3 Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakut të vetëm të shoqërisë.
- 12.4 Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhënie me të tretë, nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.
- 12.5 Administratori ka gjithashtu të drejtën të nënshkruajë kontrata të ndryshme në emër e për llogari të shoqërisë, përfshi këtu kontratat e qerasë, shitjes, blerjes a hipotekimit të pasurive të paluajtshme, të nënshkruajë akt themelimi të shoqërive të tjera ku Shoqëria është ortak, të nënshkruajë e të hartojë çdo dukument, e të kryejë në emër të shoqërisë çdo veprim përballë bankave shqiptare, apo të huaja në lidhje me çeljen, apo mnylljen e llogarive rrjedhëse të shoqërisë, nënshkrimin e kontratave të ndryshme bankare për financimin e shoqërisë, si dhe të kryejë veprime tërheqje e derdhje shumash në këto llogari pa limit.
- 12.6 Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se, të tretët e dinin që akti i administratorit e kalon objektin e shoqërisë, apo kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.
- 12.7 Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.
- 12.8 Administratorit, ose ortakëve që nuk janë persona juridik, nuk u lejohe të kontrakttojnë në çfarëdoq formë qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie, si dhe të bëhen dorëzanës, apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.
- 12.9 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 13

Përgjegjësitë e Administratorit

- 13.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë,



- i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 13.2 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:
- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 13.3 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 13.4 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.
- 13.5 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku ka të drejtë të ngrejë padi penale kundër administratorit.
Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 14

Viti financiar

- 14.1 Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.
- 14.2 Bilancet vjetore, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar, nëse është emëruar, miratohen nga Asambleja me shumicën e përcaktuar sipas ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 14.3 Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 muajve nga fundi i vitit financiar.



Neni 15 **Fitimet**

- 15.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% të destinuar për rezervën ligjore deri në 10% të kapitalit themeltar (sipas detyrimit ligjor), dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja vendos të vërë mënjanë, u shpërndahen ortakëve në proporcion me kuotat e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 15.2 Asambleja mund të vendosë dhe zbritje të vecanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo për shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.


Neni 16 **Ekspertët**

- 16.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e ortakut të vetëm, kontrolli i pasqyrave financiare dhe librave kontabël të shoqërisë mund t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar.
- 16.2 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut.
- 16.3 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.
- 16.4 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KREU V **PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

Neni 17 **Prishja dhe likuidimi**

- 17.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:
- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblese së Ortakut të Vetëm;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit";
 - d) me vendim të gjykatës;
- 17.2 Në këtë rast se ortaku i vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikohet mënyra e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".



17.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortakët. Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin përkatës për shoqëritë tregtare.

Neni 19

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit përkatës për shoqëritë tregtare, ligjit përkatës për regjistrimin e biznesit; ligjit përkatës për qendrën e biznesit, Kodit Civil, ligjit nr.8901, ligjit përkatës për falimentimin; si dhe çdo ligj tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe te tretëve, në rast se ato nuk zgjidhen me mirëkuptim, për shqyrtimin e tyre do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 21

Gjuha

Ky statut është i shkruar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

Lexuar, gjetur konform vullnetit të lirë e të pavesuar, pranuar dhe nënshkruar nga ortakët themelues:

ORTAKU I VETËM

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“EMI & AMA HOLDING COMPANY” sh.p.k.

z. Gentian LARI

Specimenti i nënshkrimit

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Gur Ali". The signature is fluid and cursive, with the first name "Gur" and the last name "Ali" clearly distinguishable.